



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

K.P.P. 609/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 30.12.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Interlogistic” shpk dhe kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Infosoft Office” shpk nga procedura e prokurimit me nr. REF-72981-09-24-2020, me objekt Loti III “Blerje letër”, me fond limit 5,730,147 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

Ankimues: “Interlogistic” shpk
Autostrada Tiranë-Durrës, km 09, Kashar

Autoriteti Kontraktor: Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Sheshi Skënderbej Nr. 3, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.09.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit me nr. REF-72981-09-24-2020, me objekt Loti III - “Blerje letër”, me fond limit 5,730,147 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.

II.2. Në datën 19.10.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 29.10.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- “Infosoft Office” shpk	3,167,970.46	lekë	I kualifikuar
- “Interlogistic” shpk	3,190,661.86	lekë	I skualifikuar
- IT “Gjergji Kompjuter” shpk	3,657,116.28	lekë	I kualifikuar
- “Marketing&Distribution” shpk	5,637,200.00	lekë	I kualifikuar

II.4. Në datën 05.11.2020 operatori ekonomik “Interlogistic” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor lidhur me skualifikimin e ofertës së tij dhe kualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” shpk, me argumentat si më poshtë:

[...]Nga sa më sipër shoqëria jonë është skualifikuar me arsyen si më poshtë:

- Nuk plotëson germa e, pika 4, seksioni 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 2, “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti të paraqesë certifikatë për transport mallrash në emër të tij. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve, me targë Tr 3041T dhe Tr 2463T të cilat i disponon shoqëria “Marketing&Distribution” shpk sipas lejeve të qarkullimit janë specifike dhe të lëshuara për kryerjen e transportit të mallrave brenda vendit vetëm për llogari të veprimtarisë së kësaj shoqërie. Në këtë mënyrë kryerja e transportit të mallrave nga ana e operatorit ekonomik “Interlogistic” shpk me kamionat e shoqërisë “Marketing&Distribution” shpk do të jetë në kushtet e kryerje së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licensën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për transportin rrugor” është i ndaluar.

Duke ju referuar arsyes së vetme të skualifikimit si më sipër, ju bëjmë me dije se në bazë të dokumentacionit të dorëzuar, kontratat e qerasë janë në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontrata është e formuluar sipas legjislacionit në fuqi duke pasur në përmbajtje të saj cdo dokumentacion të kërkuar nga ligji dhe të kërkuar nga ana juaj. Kontrata në përmbajtje ka dokumentacionin vërtetues si më poshtë dhe egzakhtësisht dokumentacionin që keni kërkuar ju në DST:

- a) Leje qarkullimi e mjetit;
- b) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;

- c) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;
- d) Certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton).

Operatori ekonomik “interlogistic” shpk nuk mund të skualifikohet për mosparaqitjen e dokumentacionit teknik/ligjor i cili nuk kërkohet nga DST.

Të gjitha pikat e mësipërme plotësojnë në mënyrë kumulative kërkesat tuaja që i keni të afishuara në DST. Kërkesa juaj që një dokument sic është Certifikata për transport mallrash është në emër të shoqërisë që disponon mjetet është një kërkesë diskriminuese dhe jo në përputhje me legjislacionin në fuqi. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me shoqërinë dhe NIPT-in e shoqërisë që i disponon ato. Ne me anë të kontratës dhe dokumentave që i janë bashkëlidhur asaj kemi treguar që mjetet disponojnë cdo certifikatë që parashikon legjislacioni në fuqi të cilat me anë të parashikimeve të kontratës noteriale i kalojnë shoqërisë qiramarrëse për përdorim deri në ditën që kjo kontratë të përfundojë. Në këtë mënyrë ne jemi plotësisht të mbuluar dhe jemi konform legjislacionit në fuqi duke përmbushur cdo kusht tuajin për procedurën e prokurimit. Duke e bërë skualifikimin tuaj të pa përligjur dhe diskriminues për shoqërinë tonë.

Në DST përcaktohet që:

“Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- e) Certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);

..... që nënkupton se “Certifikata për transport mallrash....” është një prej dokumentave të nevojshëm që do të duhet të disponohet nga qiradhënësi dhe jo nga qiramarrësi.

Rrjedhimisht AK nuk mund të skualifikojë OE Interlogistic, bazuar në dokument teknik/ligjor i cili nuk kërkohet nga DST.

2. Gjithashtu për sa i përket konstatimit të AK që:

Bazuar në lejen e qarkullimit, qiradhënësi ka të drejtë të transportojë mallra vetëm për llogari të tij...jo për llogari të të tretëve, me qira, pa licencën përkatës....

....do të donim të theksonim gjithashtu se:

- a) Në nenin 41 të ligjit “Për transportin rrugor” përcaktohet se: Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licensën përkatëse”
- b) Në pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të DST nuk përcaktohet si kriter kualifikues që: OE pjesëmarrës do të duhet të paaqesë edhe “licensën për transportin e mallrave me qira” të qiradhënësit;
- c) Nuk kuptohet si AK ka dalë në konkluzionin që Qiradhënësi “Marketing&Distribution” shpk janë specifike vetëm për kryerjen e transportit për llogari të vet është tërësisht i gabuar dhe jo i vërtetë.

- d) Qiradhënësi M&D mund të jetë i pajisur me licensë për transportin e mallrave me qera ashtu si dhe mund të mos jetë i pajisur me këtë licensë... Bazuar në kriteret dhe dokumentacionin teknik/ligjor që kërkohet nga DST, OE pjesëmarrës nuk kanë asnjë detyrim ligjor që të provojnë disponimin e kësaj licence nga ana e qiradhënësit për atë kohë sa ky dokument nuk kërkohet në DST.

Rrjedhimisht AK nuk mund të skualifikojë OE Interlogistic shpk bazuar në një dokument teknik/ligjor i cili nuk kërkohet në DST.

Gjithashtu në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik "Infosoft Office" shpk po ju paraqesim kundërshtitë si më poshtë:

1. Operatori ekonomik "Infosoft Office" shpk mendojmë se nuk përmbush kriteret kualifikuese të përcaktuara në DST e procedurës prokuruese objekt i kësaj ankese si dhe nuk ka depozituar pranë AK në mënyrë të saktë dhe të plotë dokumentacionin ligjor dhe teknik të kërkuar në DST;
- a) Operatori ekonomik "Infosoft Office" shpk mendojmë se nuk ka paraqitur shtojcën 5 "Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme" në përputhje me aktet normative të fushës, aktualisht në fuqi, të përmirësuara së fundmi.
- b) Nuk janë vetëdeklaruar:
 - Të gjithë ortakët e Infosoft Office shpk
 - Të gjithë ortakët dhe administratorët e shoqërisë Dobi management
 - Gjithashtu nuk janë vendosur ID e asnjërit nga personat e sipërcituar më më sipër për të mundësuar verifikimet e AK.
- c) Operatori ekonomik "Infosoft Office" shpk mendojmë se nuk ka paraqitur dokumentin për të vërtetuar se ka shlyer të gjitha detyrimet në lidhje me energjinë elektrike për të gjitha rezidencat/adresat tatimore, sipas ekstraktit të QKR.
- d) Operatori ekonomik "Infosoft Office" shpk mendojmë se nuk ka paraqitur dokumentacionin e nevojshëm teknik/ligjor (përfshirë këtu mangësi në dokumentacion për sa i përket origjinalitetit dhe përkthimit dhe njësisimit me origjinalin) për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara të transportit në pikën 2.3.1 të DST.

Për sa më sipër në zbatim dhe në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, kërkojmë:

- Kualifikimin e operatorit ekonomik "Interlogistic" shpk;
- Skualifikimin e Operatorit Ekonomik "Infosoft Office" shpk.

II.6. Në datën 10.11.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ku ka vendosur mospranimin e ankesës.

II.7. Në datën 17.11.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtat pretendime që ka paraqitur në Autoritet

Kontraktor duke kërkuar kualifikimin e operatorit ekonomik “Interlogistic” shpk dhe skualifikimin e ofertës së Operatorit ekonomik "Infosoft Office" shpk.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr.2335/1 prot, datë 27.11.2020 protokolluar me tonën me nr.1519/2 prot datë 02.12.2020 me objekt “Dërgim dokumentacioni për lotin 3: “Blerje letër” për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje materiale kancelarie” e ndarë në 3 (tre) lote”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” shpk mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se *Nuk plotëson germa e, pika 4, seksioni 2.3 Kapaciteti Teknik, pika 2, “Kriteret e vecanta të kualifikimit” pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti të paraqesë certifikatë për transport mallrash në emër të tij. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se certifikatat e mjeteve, me targë Tr 3041T dhe Tr 2463T të cilat i disponon shoqëria “Marketing&Distribution” shpk sipas lejeve të qarkullimit janë specifike dhe të lëshuara për kryerjen e transportit të mallrave brenda vendit vetëm për llogari të veprimtarisë së kësaj shoqërie. Në këtë mënyrë kryerja e transportit të mallrave nga ana e operatorit ekonomik “Interlogistic” shpk me kamionat e shoqërisë “Marketing&Distribution” shpk do të jetë në kushtet e kryerje së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licensën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për transportin rrugor” është i ndaluar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.1.1. Në shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3/5/g të dokumentave të tenderit, është parashikuar plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

1. *Operatori ekonomik duhet të disponojë minimumi 1 (një) mjet transporti mallrash, me qëllim transportin e mallrave, të cilin duhet ta ketë në pronësi, ose me qira, dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin përkatës, si më poshtë:*
 - g) *Dokumentacion që vërteton pronësinë ose marrjen me qera:*
 - *Dokumentacioni që vërteton pronësinë:*
 - *Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj / Kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit / Çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.*
 - *Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:*
 - *Kontratë qiraje.*

- h) Leje qarkullimi e mjetit;
- i) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore;
- j) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve;
- k) Certificate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton);
- l) Leje drejtimi automjeti, për të paktën 1 (një) prej punonjësve.

III.1.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.

III.1.3. Në nenin 27 pika 3 “Kontrata e mallrave” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, parashikohet si më poshtë: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”.

III.1.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatori ekonomik “Interlogistic” sh.p.k, rezulton se përsa i përket mjeteve të transportit (kamionëve), ka paraqitur:

- Kontratë qiraje Nr. 1800 Rep dhe Nr.151 Kol datë 15.10.2020, të lidhur, ndërmjet shoqërisë “Marketing&Distribution” sh.p.k., në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Interlogistic” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, për dhënien me qira të mjetit me targë TR 3041T, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës për një periudhë 2 vjecare.

Për mjetin me targë TR 3041T është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Leje qarkullimi e mjetit për përdorim vetjak
- Certifikatë pronësie e mjetit
- Çertifikate e kontrollit teknik;
- Siguracioni i mjetit,
- Çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit për llogari të vet (në përdorim të personit juridik “Marketing&Distribution” sh.p.k).

- Kontratë qiraje Nr. 1801 Rep dhe Nr.152 Kol datë 15.10.2020, të lidhur, ndërmjet shoqërisë “Marketing&Distribution” sh.p.k., në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Interlogistic” sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, për dhënien me qira të mjetit kamion me targë TR 2463T, për një periudhë 2 vjecare, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

Për mjetin me targë TR 2463T është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

- Leje qarkullimi e mjetit për përdorin vetjak
- Certifikatë pronësie e mjetit
- Çertifikaten e kontrollit teknik;
- Siguracionin e mjetit,
- Çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit për llogari të vet (në përdorim të personit juridik “Marketing&Distribution” sh.p.k).

III.1.5. Në nenin 81, pika 1,2,3,4,5 dhe 7,8 “Destinacioni dhe Përdorimi i Mjeteve” i ligjit nr.8378 datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]”

1. Me destinacion të mjetit nënkuptohet përdorimi i tij në bazë të karakteristikave teknike.
2. Me përdorim të mjetit nënkuptohet shfrytëzimi i tij ekonomik
3. Mjetet mund të caktohen për përdorim vetjak ose për përdorim nga të tretët.
4. Quhet përdorim nga të tretët kur mjetet shfrytëzohen, kundrejt pagesës përkatëse, nga persona të tjerë të ndryshëm nga titullari i lejes së qarkullimit. Për rastet e tjera nënkuptohet përdorimi vetjak i mjetit.
5. Përdorimi nga të tretët përfshin:
 - a) dhënien me qira pa drejtues mjeti;
 - b) dhënien me qira me drejtues mjeti dhe shërbimi taksi për transport njerëzish;
 - c) shërbimin e linjës për transport pasagjerësh;
 - d) shërbimin e transportit të mallrave për llogari të të treteve;
 - e) shërbimin e linjës për transportin e mallrave;
 - f) shërbimin taksi për transportin e mallrave për llogari të të treteve.

....

7.Në aktet në zbatim janë përcaktuar karakteristikat konstruktive të mjetit në lidhje me destinacionin ose përdorimet, për të cilat ai mund të caktohet.

8. Duke përjashtuar dispozitat e ligjeve të posaçme, cilido që shfrytëzon një mjet me një destinacion ose për një përdorim të ndryshëm nga ato të treguara në lejen e transportit, ndëshkohet me masë administrative me gjobë nga pesë mijë deri në njëzet mijë lekë. [...]”

Në nenin 3, paragrafi 3.13 dhe 3.14 të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] 3.13. Transport për vete: transporti i mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi.

3.14. Transport për të tretë dhe me qira: transporti i mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira. [...]”

Në nenin 41, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998 *“Për transportet rrugore”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Transporti i mallrave me qira dhe për të tretë është i ndaluar të kryhet pa licencën përkatëse.”*

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se *lex specialis*, ligji *“Për Transportet Rrugore”*, bën qartësisht ndarjen midis çertifikatës së lëshuar për *“Transport për vetë”* përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion, në ardhje ose në kthim, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet, ku në këtë rast transporti është vetëm një veprimtari ndihmëse e veprimtarisë kryesore, e cila vërtetohet sipas ligjeve në fuqi; si edhe çertifikatës së lëshuar për *“Transport për të tretë dhe me qira”* përmes të cilës subjektet mund të kryejnë transport të mallrave me kamion për persona fizikë a juridikë të tjerë ose dhënia e kamionit me qira.

Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se, çertifikatat e mjeteve me targë TR 3041T dhe TR 2463T të cilat i disponon shoqëria *“Marketing&Distribution”* sh.p.k., sipas lejeve të qarkullimit, me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton, janë specifike dhe të lëshuara vetëm për transport për vetë, përmes së cilave është i licencuar vetëm ky subjekt dhe janë dhënë në përdorim në emër të personit juridik *“Marketing&Distribution”* sh.p.k., për kryerjen e transportit të mallrave me kamion, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit nga ana e shoqërisë *“Interlogistic”* sh.p.k. të mallrave me kamionët e sipërcituar të shoqërisë *“Marketing&Distribution”* sh.p.k. do të jenë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit *“Për Transportet Rrugore”* është i ndaluar.

K.P.P. gjykon se licenca e mësipërme është pjesë e dokumenteve të nevojshme që vërtetojnë se mjeti është në përdorim nga operatorët ekonomikë.

Mungesa e licencës së mësipërme, vërteton vetëm faktin se mjeti mund të jetë në pronësi, por përdorimi i tij do të ishte i pamundur në zbatim të dispozitave të sipërcituara të Kodit Rrugor të RSH-së dhe të ligjit *“Për Transportin Rrugor”*.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Mungesa e dokumentacionit të mësipërm do të sillte pamundësinë e realizimit me sukses të kontratës, pasi mjetet nuk do të kishin mundësi të qarkullonin.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik *“Interlogistic”* sh.p.k., për plotësimin e kriterit *“Certifikatë për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1.5 ton)”* në procedurën e prokurimit objekt ankimi nuk konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” sh.p.k për skualifikimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P-se mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” shpk për procedurën e prokurimit, me nr. REF-72981-09-24-2020, me objekt Loti III - “Blerje letër”, me fond limit 5,730,147 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 19.10.2020 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.1519 Protokoli, Datë 17.11.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri